



REPUBLIKA E SHQIPERISË

**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE**

Nr. 10 Prot.

Tiranë, më 23/05/2024

**U D H Ë Z I M**

**Nr. 1, datë 23/05/2024**

**P Ë R**

**SHPALLJEN E AFATEVE TË KANDIDIMIT, SI DHE DORËZIMIN E  
DOKUMENTACIONIT PËR DREJTUES TË NJËSISË KRYESORE, DREJTUES TË  
NJËSISË BAZË, SI DHE ANËTARË TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME PËR  
DHËNIEN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR"**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese 2024 – 2028, në Universitetin Politeknik të Tiranës", neni 6, pika 2, neni 18 dhe 25, si dhe vendimin nr. 1, datë 20/05/2024 të KIZ" Për konstituimin e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) në Universitetin Politeknik të Tiranës, si dhe zgjedhjen e kryetarit të tij", në mbledhjen e datës 23.05.2024 Komisioni Institucional i Zgjedhjeve,

**UDHËZON:**


1. Komisionet e Zgjedhjeve në Fakultete (KZF), të shpallin afatin për fillimin e dorëzimit të dokumentacionit të vetëkandidimit në KIZ.
2. Afati për dorëzimin e dokumentacionit të fillojë në datën 27.05.2024 dhe të përfundojë në datën 31.05.2024, ora 16:00.
3. Komisionet e Zgjedhjeve në Fakultete, të shpallin kriteret dhe listën e dokumentacionit për kandidim në përputhje me nenin 25, pika 1 të rregullores.
4. Dokumentacioni i kandidimit për drejtues të njësisë kryesore, drejtues të njësisë bazë, si dhe anëtarë të Komisioneve të Përherëshme për Dhënie të Gradës Shkencore "Doktor" do të dorëzohet pranë Komisionit Institucional të Zgjedhjeve, sipas nenit 25, pika 1 të rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese 2024–2028 në Universitetin Politeknik të Tiranës".

5. KZF- të do të tërheqin listën e dokumentave të dorëzuar pranë KIZ në datën 31.05.2024, ora 16:30 për të kryer regjistrimin përfundimtar dhe shpalljen e kandidatëve jo më vonë se 24 orë nga dita e marrjes në dorëzim të dokumentacionit.
6. Brenda datës 03.06.2024, KZF të dërgojnë në KIZ një kopje të vendimit për regjistrimin e kandidatëve. Vendimi publikohet nga KZF dhe një kopje e tij i vihet në dispozicion KIZ.
7. Formularët që duhet të plotësohen nga kandidatët për drejtues të njësisë kryesore, drejtues të njësisë bazë, si dhe anëtarë të Komisioneve të Përhershme për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, janë sipas modeleve bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëhere.

### KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Edmond PERGEGA

Kryetar 


Alfred PJETRI

Anëtar 


Albina BASHOLLI

Anëtar 


Anjeza DULAJ (GJINI)

Anëtar 

Nelda KOTE

Anëtar 


Irida GJOKA (MARKJA)

Anëtar 

Klajdi QOSHI

Anëtar 

Pietro BELBA

Anëtar 

Lidia HYSA

Anëtar 